



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 130 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal me Nr.03/L-49, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2011 merr këtë:

**VENDIM  
PËR  
RIDESTINIM TË MJETEVE FINANCIARE**

**I**

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 01/Nr.130/2011 për ridestitim të mjeteve financiare.

**II**

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës dhe anëtarëve të Kuvendit të Komunës për shkak se gjatë tenderimit të projekteve kapitale një sasi e mjeteve financiare kanë mbetur të porealizuara dhe mjetet e mbetura i realizojmë në projektet tjera kapitale.

**III**

Duke iu referuar nenit I të këtij vendimi mjetet financiare që ridestinohen në projektet kapitale janë: nga grandi qeveritar (fondi 10) në shumën prej 1,000 €, nga të hyrat vetanake (fondi 21) në shumën prej 25,716 € dhe nga të hyrat vetanake (fondi 22) në shumën prej 5,000 €, pra në total ridestnimi i mjeteve financiare është në shumën prej 31,716 €, pra nga programi buxhetor Planifikimi urban dhe mjedisi.

Ridestnimi i projekteve kapitale nga grandi qeveritar (fondi 10)

Nga programi (660) Planifikim Urban dhe mjedis, nën-programi (66480) planifikimi urban dhe inspeksioni kemi këto ridestime brenda programit planifikimi urban dhe mjedisi : Nga projekti "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit" kodi (84097) shuma prej 1,000€ të ridestinohet në projektin "Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë" kodi (84094) në shumën prej 1,000 €.

Ridestnimi i projekteve kapitale brenda programit Planifikim urban dhe mjedisi (660), nën-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) nga të hyrat vetanake fondi 21.

Nga projektet "Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave" kodi (84096) shuma prej 8,656€ dhe "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) shuma prej 1,344 € të ridestinohen në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 10,000€. Nga projekti "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e

ujësjellësit” kodi (84097) shuma prej 4,000€ të ridestinohet në projektin “Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë” kodi (84094) në shumën prej 4,000 €. Nga projekti “Autoambulancë për nevoja të QKMF-së në Han të Elezit” kodi (83399) shuma prej 8.000 € të ridestinohet në projektin “Dislokimi i trafos në qytet kodi (83552) në shumën prej 8,000 €. Nga projektet “Autoambulancë për nevoje të QKMF-së në Han të Elezit” kodi (83399) shuma prej 888 €, “Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re “ kodi (83394) shuma prej 2,628 €, “Softuer për kontabilitet kodi (83401) shuma prej 200 € të ridestinohen në projektin “Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit – Dimcë” kodi (83386) në shumën prej 3,716 €.

Ridestnimi i projekteve kapitale brenda programit Planifikim urban dhe mjedisi (660), nën-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) nga të hyrat vetanake fondi 22

Nga projekti “Fondi për shpronësim” kodi (81430) shuma prej 5,000 € të ridestinohet në projektin “Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë” kodi (84094) në shumën prej 5,000 €.

#### IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

#### V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 31.10.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Menduh Vlasi

